

EVALDA PACI

ÇËSHTJE TË SHQIPËRIMIT TË TEKSTIT BIBLIK NË VEPRAT E LETËRSISË SË VJETËR SHQIPE

Problematika e shqipërimit të teksteve biblike në gjuhën shqipe përfshin patjetër një radhë sprovash që sollën ndër të tjera dhe realizime veprash që përfaqësojnë një periudhë të rëndësishme të historisë së letërsisë sonë të shkruar. Autorët e kësaj tradite e në veçanti shkrimtarët emri i të cilëve lidhet me letërsinë e vjetër shqipe, janë përfshirë në këtë problematikë nga vetë tematika e veprave që kanë ndërmarrë për të përpiluar¹.

Meshari (1555) i Gjon Buzukut është në këtë rasë një burim argumentesh në lidhje me shumë tekste që përmbahen në të. Për vetë modelin kompleks që libri paraqet, dhe vetë tekstet e tij mund të jenë të ndryshme në pikëpamje të gjatësisë, destinacionit dhe të ndërtimit të tyre. Mund të gjurmohet një lloj vijimësie apo lineariteti dhe në tekstet që janë pjesë e praktikës së liturgjisë (sa u përket lutjeve të caktuara dhe përdorimeve kyçe në përbërje të tyre); gjurmohen gjithashtu tipare të përbashkëta dhe sa u takon psalmeve. Në disa këngë a himne si dhe në disa pjesë biblike vihen re përdorime të caktuara që dëshmojnë se burimet e konsultimit mund të kenë qenë të ndryshme. Veçanërisht në përbërje të teksteve biblike mund të ndiqet ecuria e shqipërimit të sintagmave të caktuara, e shfaqjes së përdorimeve specifike për pjesë të veçanta, e paraqitjes së emrave të përveçëm që përfaqësojnë një nomenklaturë të pasur në përbërje të vetë librit. Nëse flitet pikërisht për tekstin biblik, në qendër të vëmendjes vijnë përdorime më specifike siç janë emërtimet e festave më të rëndësishme dhe tipologjia e paraqitjes së tyre në shqipen e kohës; leksiku i hierarkisë i parë në raport qasjeje mes pjesëve të Besëlidhjes së Vjetër dhe asaj të Re²; leksiku i së drejtës romake dhe elemente themelore të

¹ Përmenden në këtë trajtesë autorë të veçantë ndër të cilët Gjon Buzuku dhe Pjetër Bogdani. Gjithsecili i ka sjellë tekstet dhe motivet biblike sipas natyrës së veprës përkatëse, e veçantë gjithsecila në modelin e ndërtimit dhe strukturimin përkatës. Sa mund të përfshihet në këtë çështje dhe Dicionari i Frang Bardhi t(1635), një vepër që vë në qasje mes njëra-tjetrës kryesisht latinishten dhe shqipen e kohës së tij? Për vetë lemat e përzgjedhura, shqyrtimi i këtij aspekti në përmbajtje të Dicionarit është i pashmangshëm. Pavarësisht se njihet fakti që në përbërje të këtij fjalori nuk ndiqen kritere të mirëfillta të përzgjedhjes së fjalëve të trajtuara, lema të caktuara që janë elemente konstitutive të një regjistri gjuhësor të rëndësishëm siç është ai i leksikut të liturgjisë, shërbejnë si të dhëna për vjeljen e këtij leksiku te ky autor.

² Diversiteti gjuhësor është shtruar si tipar i rëndësishëm në studimet më të mira kushtuar këtij libri. Ai mbetet një element i pashmangshëm për diskutim aq më tepër kur objekt studimi është pikërisht çështja e përshtatjes, e përkthimit, e shqipërimit të teksteve të tij.

botës hebraike; toponimia e botës antike me të gjitha variantet e gjindshme të emrave të vendeve; emrat e përveçëm të personazheve biblike. Të gjitha janë detaje që të çojnë drejt tekstesh të caktuara referenciale dhe në reflektime mbi dallimet që paraqesin vetë tekstet biblike. Dallimet vihen re më së miri kur i njëjti emër përdoret në tekstet e Besëlidhjes së Vjetër dhe më tej në ungjijtë³. Nganjëherë është vendosur për trajta rasore që marrin tipare morfologjike si të emrave të tjerë në shqipen e kohës, por ndonjëherë trajtat që janë sjellë në tekst janë pothuaj njësoj si në tekstet referenciale në gjuhën latine. I njëjti problem qëndron dhe për disa emra të përveçëm dhe ky fakt bie në sy veçanërisht kur i njëjti emër qëllon të përdoret me se një herë në raste tekstesh relativisht të gjata siç janë ato të Liturgjisë së Pashkëve e që kanë të bëjnë me Pasionën. Këtu duhet shtuar që vihet re se përdorime të caktuara janë më të konsoliduara në pikëpamje të trajtave paradigmatiske, ndërkohë që më problematike paraqitet çështja e emrave të përveçëm e në veçanti të personazheve biblike⁴.

Një diskutim i kësaj natyre nuk mund të kufizohet vetëm në çështje të analizës së tipareve morfologjike të fjalëve të caktuara. Ai përfshin dhe çështje të shqipërimit të teksteve që janë pjesë e praktikës së liturgjisë dhe përfaqësojnë gjini të caktuara në zhanrin e himnodisë liturgjike. Një pjesë e këtyre teksteve janë të vendosura pikërisht në pjesën e parë të librit dhe për më tepër dallohen ndër të tjera dhe për një prurje të tepruar fjalësh të huaja nëse qasen në këtë pikëpamje me tekste që përdoren më tej, në përbërje të Mesharit. Megjithatë me to shfaqen për herë të parë përdorime të caktuara që i përkasin fushës së liturgjisë dhe terminologjisë përkatëse. Analiza bëhet më interesante nëse kemi parasysh dhe faktin që për vetë praninë e tyre në librin e Offices rimerren disa herë duke bërë të mundur të vihen re tipare të formës dhe të përmbajtjes⁵. Në këtë pikëpamje mund të bëhen objekt shqyrtimi në veçanti

³ Rimarrja e emrave të vendeve në tekstet e *Mesharit* sigurisht kërkon një lloj studimi nisur nga premisa që në libër nuk është arritur të sillen paradigma të plota apo të unifikuara të tyre në gjuhën shqipe. Shih ndër të tjera dhe përdorimet *Jeruzalem* e *Jerozolimë* në të njëjtin tekst biblik të *Meshari*, *botim kritik i cituar*, Tiranë, 1968, f. 97/a.

⁴ Sa i përket ndërtimit sintetik *Zotynë*, duhet cilësuar fakti që ai ka një përdorim mjaft të shpeshtë në përbërje të teksteve të caktuara, veçanërisht të Psalmes dhe në pjesët biblike nga BV. Gjithashtu, në tekstin përmbyllës të librit (kolofonin) ky ndërtim gjurmohet në një sërë trajtash që pothuaj rindërtojnë krejt paradigmen e tij.

⁵ Për këto rimarrje qoftë dhe të teksteve të njëjta biblike shih në veçanti të *Meshari*, *botim kritik gatitur nga Eqrem Çabej*, Tiranë, 1968, përkatësisht f. 27/b; f. 59/a. Dhe për emra të përveçëm personash duhet parë se ato rimerren me trajta jo krejt të njëjta dhe brenda të njëjtit tekst, për të mos lënë pa përmendur dhe faktin që po ai tekst mund të rimerret më tej në përbërje të librit. Shih për këtë disa rimarrje të një teksti nga Ungjilli sipas Lukës të *Meshari*, *botim kritik i cituar*, përkatësisht f. 91/a-b; dhe më tej, po ai botim, në f. 333/b. Këto dallime janë me vend të vihen në dukje dhe në lidhje me emra vendesh në tekstet e *Mesharit*, në veçanti kur i njëjti emër rimerret në tekste të ndryshme.

psalmet e konkretisht ato të pendesës, himnet dhe këngët më të veçanta që përfshihen tradicionalisht në përbërje të Offices e që njëkohësisht për nga origjina janë pasazhe nga ungjijtë. Rimarrja e tyre bie në sy veçanërisht në këtë pjesë të librit me gjithë diferencimet përkatëse në pikëpamje gjuhësore.

Duke qenë se diskutimet rreth librit kanë përfshirë dhe vetë rrethanat e hartimit të librit me ngjarjet e kohës, mjaft të rëndësishme për historinë e kishës së Romës në veçanti, raportet e hamendësuara të autorit me hierarkinë kishtarë të kohës, tekste të caktuara e sidomos ato të pjesëve hyrëse të librit mund të ndihmojnë për të shpënë në një hap të mëtejshëm të tilla diskutime. Ndryshimet që iu bënë Vulgatës sigurisht që nuk përfshinë mbarë librin dhe kishin të bënin me tekste të caktuara, të sqaruara këto në dokumentacionin përkatës të botimeve ad hoc⁶.

Në një optikë të veçantë mendojmë se duhet parë vepra e Pjetër Bogdanit, e cila pa dyshim ofron një objekt më të gjerë gjurmimi për vetë shtjellimin e argumenteve të trajtuara në vepër. Bogdani ka cituar mjaft shpesh fraza e tekste të tëra: ai ka përzgjedhur nga librat e profetëve⁷, nga psalmet si dhe nga letrat e Apostujve. Tekstet biblike dhe fryma biblike janë mjaft të pranishme në veprën e tij, e jo vetëm nëpërmjet citimeve të sipërpërmendura. Asnjë prej përzgjedhjeve që rezultojnë në libër nuk janë të rastësishme. Shembujt që mund t'i shërbejnë argumentit qendror të kësaj trajtese janë të shumtë, meqë larmia e përzgjedhjes së teksteve nga kjo fushë, qoftë dhe nga veprat e etërve të kishës është tejet e zgjeruar.

Një numër jo i vogël citimesh të Bogdani janë marrë pikërisht nga Besëlidhja e Vjetër dhe nga tekste të cilat lidhen drejtpërdrejt me tematikën e ligjëratave në të cilat ai e ka strukturuar veprën e tij: Deuteronomi, Ekleziasti etj. Në botimin kritik të veprës *Cuneus prophetarum* të përgatitur nga studiuesja Anila Omari merren në shqyrtim një sërë përdorimesh që kanë të bëjnë me fjalë të veçanta, me ndërtime sintagmatike dhe çka është më e rëndësishme, shënimet përkatëse janë të orientuara nga një vështrim përfaqësues me të tjera variante, në gjuhën latine apo dhe nga shpjegimet e dhëna mbi to nga studiues të tjerë gjithnjë në lidhje me të njëjtin argument. Të tilla vërejtje që synojnë saktësimin kuptimor të fjalëve të caktuara, që përfshijnë dhe përdorime alternative të së njëjtës fjalë në të tjera kontekste, përbëjnë një prej kontributeve më të rëndësishme të studiueses Omari në lidhje me orientimin e brendësimit kuptimor të teksteve të vetë veprës.

Prurjet në veprën e Pjetër Bogdanit janë të një pasurie që i kalon përmasat e së zakonshmes. Jo vetëm tekstet e cituara në përbërje të ligjëratave të veprës,

⁶ Shih në veçanti *Psalmi et cantici iuxta Novæ Vulgatæ editionis textum*, Libreria editrice Vaticana, Typis Vaticanis, 1999, f. 5-10.

⁷ Shih ndër të tjera dhe incipit-in që introdukon *Të primitë para letërsarit nga libri i Isaisë, 5: Propterea captivus ductus est populus meus, quia non habuit scientiam*.

por dhe vetë të shkruarit e autorit, vendi dhe rëndësia që ai i kushton përdorimit të një leksiku dituror nga fusha të ndryshme të dijes, përdorimet sintagmatike që bëjnë të shqyrtohen raporte me të tjera gjuhë me të cilat ai ka qenë në kontakt falë rrethanave jetësore dhe formimit të shumanshëm human dhe profesional, janë të gjitha fakte që nuk lihen jashtë vëmendjes qoftë dhe kur shqyrtohet problematika e shqipërimit të tekstit biblik në veprën e tij. Leksiku i teologjisë me përfatesat themelore të tij sigurisht që ka vënë në sprovë jo të vogël përgjegjësinë e autorit të veprës në realizimin e thënieve dhe argumentimeve, por ka kërkuar njëkohësisht dhe një sërë citimesh nga tekstet biblike, në veçanti kur trajtohen dogma dhe nocione bazilare: Trinia Shenjte, ekzistenca e një Hyji të vetëm etj.

Të tilla tekste, të vëna në përbërje të veprës në variante në gjuhën latine, ndonjëherë dhe në italishten e kohës si dhe në gjuhën shqipe sigurisht të krijojnë mundësinë e reflektimit mbi zgjidhjet e autorit ndërsa shqipëron gjithsecilin përdorim. Kujdesi i tij vihet re ndërsa dallon mes emërtesave të caktuara ndërkohë që citon nga Gjeneza, librat e profetëve etj. Ndërkohë dhe mund të reflektohet se përdorime të caktuara mund të kenë arritur një shkallë konsolidimi e praktikimi që nuk e kishin në kohën kur u realizuan veprat paraardhëse po aq të rëndësishme që i përkasin së njëjtës traditë shkrimore.

Teksti latin në veprën e Bogdanit natyrshëm është cituar në vende të ndryshme, por njëkohësisht ka sjellë në vëmendje të vetë autorit e më pas dhe të lexuesit të specializuar përmbajtjen e tij në gjuhën tonë, fakt ky jo pak i rëndësishëm dhe për vetë kohën kur u realizua kjo vepër. Në këtë pikë patjetër duhet vënë në dukje se këto tekste jo rrallë i kanë shërbyer autorit në pikëpamje funksionale, për të ndërtuar artifice stilistikore dhe për të introduktuar interpretime të tëra të shtrira në përmasa tekstore që qëndrojnë në bazë të krejt strukturimit të kësaj vepre.

Elementet latine gjithashtu ofrohen në një optikë të ndryshme qoftë pse gjurmohen në tekste të shtjelluara, qoftë dhe për vetë nivelin e shtrirjes së ligjëratave të veprës. Leksiku i teologjisë dhe terminologjia e liturgjisë mund të bëhen objekt i veçantë studimi në këtë vepër duke marrë parasysh dhe prurjet me këto elemente të sipërpërmendura.

Duke iu referuar një tradite të konsiderueshme studimesh paraardhëse që e bëjnë veprën e Pjetër Bogdanit objekt shqyrtimi nga studiues të disiplinave të përafërta, mbetemi të mendimit se hulumtimi në një dimension të natyrës përfaqëse e jo vetëm gjuhësore, mund të nxirrte në pah të tjera aspekte të përmbajtjes, që i takojnë me siguri dhe çështjeve të ezegjezës biblike, problematikë që duket qartë se autori e merr përsipër me vetë tematikën që ka përzgjedhur të trajtojë në veprën e tij.

Këto vepra që u bënë objekt shqyrtimi në përmasat e një trajtimi sintetik mbeten për t'u vlerësuar dhe në këtë pikëpamje: për faktin se përfaqësojnë

sprova të mirëfillta në drejtim të shqipërimit të tekstit biblik në gjuhën shqipe e pikërisht në një fazë të rëndësishme të konsolidimit të vetë shkrimit shqip dhe përvijimit të letërsisë së shkruar shqipe.

BIBLIOGRAFI

- B. Demiraj, *Dictionarium latino-epiroticum*(Romæ, 1635), per R.D. Franciscum Blanchum, Botime Françeskane, Shkodër, 2008.
- B. Demiraj, *Gjon Nikollë Kazazi dhe "doktrina" e tij*, ASHAK, Prishtinë, 2006.
- B. Demiraj, *Jeta dhe trashëgimia e Gjon P. Nikollë Kazazit*, Botime Françeskane, Shkodër, 2013.
- E. Çabej, *Pjetër Budi dhe gjuha e tij*, në SF n. 4, 1966.
- E. Çabej, *Studime gjuhësore II*, Botime Rilindja, Prishtinë, 1976.
- E. Çabej, *Studime shqiptare, Vepra të zgjedhura*, ASHAK, Prishtinë, 2008.
- E. Çabej, *Shqipja në kapërcyell-Epoka dhe gjuha e Gjon Buzikut*, Botime Çabej, Tiranë, 2006.
- E. Çabej, *Tekstet e vjetra shqip dhe disa kritere rreth botimit të tyre*, në BUSHT, n. 2, 1959.
- E. Çabej, *Vepra e Gjon Buzikut në vështrim gjuhësor historik*, SF n. 1, 1979.
- E. Paci, *Kolofoni në Mesharin e Gjon Buzikut*, në Hylli i Dritës, n. 1, 2012.
- E. Paci, *Për një vështrim tekstologjik të Mesharit të Gjon Buzikut*, në Hylli i Dritës, n. 3, 2011.
- E. Paci, *Sistemi mbiemëror në Mesharin e Gjon Buzikut*, Botimet Albanologjike, Tiranë, 2011.
- F. Blanchus, *Dictionarium latino-epiroticum*, Botime Çabej, Tiranë, 2006.
- J. Matzinger, *L'ordine dei nomi dei santi nella litania di Ognissanti nel Manuale Pastorale ("Messale") di Gjon Buzuku*, në Hylli i Dritës, nr. 4, 2010.
- K. Ashta, *Leksiku historik i gjuhës shqipe I*, Shkodër, 1996.
- K. Ashta, *Leksiku historik i gjuhës shqipe II*, Botimet Toena, Tiranë, 1998.
- K. Ashta, *Leksiku historik i gjuhës shqipe III*, Shkodër, 2000.
- K. Ashta, *Leksiku historik i gjuhës shqipe IV*, Botime Camaj-Pipa, Shkodër, 2002.
- K. Jorgaqi, *Ndikimi i italishtes në letërsinë e vjetër shqipe (XVI-XVII)*, Botime Toena, Tiranë, 2001.
- M. Camaj, *Il «Messale» di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, Shêjzat, Romë, 1960.
- M. Sciambra, *Bogdanica (Studi su Bogdani e l'opera sua), volume II, Saggio sul lessico scientifico e culturale del Bogdani*, Casa editrice Pàtron, Bologna, 1965.
- N. Ressuli, *Il "Messale" di Giovanni Buzuku, riproduzione e trascrizione*, Biblioteca Apostolica Vaticana, 1958.
- P. Bogdani, *Cuneus prophetarum, botim kritik i përgatitur nga A.Omari*, Tiranë, 2005.
- P. Budi, *Poezi (1618-1621), (botim kritik përg. nga R.Ismajli)*, Rilindja, Prishtinë, 1986.
- P. Budi, *Poezi, (Parathënia, tejshkrimi dhe komentet: R.Ismajli)*, ASHAK, Prishtinë, 2006.
- P. Geci, *Frang Bardhi dhe fjalori i tij latin-shqip*, SF n. 2, 1965.
- R. Ismajli, *Tekste të vjetra*, Botime Dukagjini, 2000.
- Zamputti I., *Çështje të shkrimit dhe të fillimit të letërsisë në gjuhën shqipe*, në HD 1-2, 1995.

